Sinjalizime

Policia ndal "Opel Vectra"-n në magjistralen Prishtinë–Ferizaj, i gjen armë dhe fishekë 29-vjeçarit

Sinjali.com 19 Maj 2026 09:10

Një kontroll rutinë i Policisë në magjistralen Prishtinë–Ferizaj ka rezultuar me sekuestrim arme dhe arrestim të një të riu, raporton Gazeta Sinjali.

Burime të Sinjalit bëjnë të ditur se njësia e trafikut kishte ndalur një veturë të tipit *"Opel Vectra"* në zonën e Preocës, kur gjatë kontrollit është gjetur një armë zjarri e tipit *"Zoraki 917-T"* dhe pesë fishekë.

Arma dyshohet se mbahej pa autorizim nga Jetmir Bejtullahu, i cili ishte në veturë në momentin e ndalimit.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet relevante policore, të cilat kanë konfiskuar armën dhe municionin, ndërsa të dyshuarin e kanë shoqëruar në stacion policor për intervistim.

Pas konsultimit me Prokurorin e shtetit, rasti është iniciuar si "*Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës*", ndërsa i dyshuari është dërguar në mbajtje.

Rasti i është kaluar njësisë së hetimeve për procedura të mëtejshme.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.

All rights are reserved 2025, Copyright Sinjali.com